



*KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.*

KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVËS Sh.a

APLIKIMI TARIFOR PËR VITIN 2012

**Pjesa III – Çmimi me shumicë i energjisë elektrike
për vitin 2012**

Përmbajtja:

I. Hyrje

II. Supozimet e bëra për të zhvilluar çmimin me shumicë të energjisë elektrike

III. Përcaktimi i çmimit me shumicë të energjisë elektrike për vitin 2012

I. Hyrje

Legjislacioni për Energjinë në Kosovë është rishikuar në Dhjetor 2010 dhe ka kërkuar nga ZRrE-ja që të ndryshojë legjislacionin e saj sekondar që të jetë në përputhshmëri me ligjet e reja. Në Nëntor 2011, ZRrE-ja ka miratuar Rregullat e reja të Çmimeve për secilin aktivitet të Licensuarve si në vijim:

- Rregulla për vendosjen e çmimeve të gjenerimit
- Rregulla për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të transmisionit dhe të tregut
- Rregulla për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes
- Rregulla për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike

Rregullat e reja të çmimeve rezultojnë në një ndryshim të rëndësishëm në mënyrën me të cilën janë zhvilluar tarifat fillimisht dhe më pas modifikuar në vitet pasuese. KEK-u ka shpenzuar kohë të konsiderueshme duke studiuar dhe komentuar materialet e ndryshme konsultative deri në nxjerrjen përfundimtare të rregullave të çmimit në nëntor 2011. Përveç kësaj, KEK-u ka studiuar gjerësisht rregullat përfundimtare në mënyrë që të përgatisë këtë aplikacionin për tarifa dhe dokumentacionin mbështetës për të qenë në përputhje me rregullat e reja.

Siç shpjegohet në Pjesën I të këtij aplikacioni për tarifa, në mënyrë që të jenë në përputhje me mekanizmat e rinj të shthurur të çmimeve që janë duke u zbatuar nga ZRRE-ja, Aplikimi Tarifor i KEK-ut për vitin 2012 do të përbëhet nga pesë (5) pjesë si më poshtë:

Pjesa I Informacioni bazë për të gjithë të licencuarit

Pjesa II Aplikimi tarifor për Gjenerim

Pjesa III Çmimi me shumicë i energjisë elektrike për vitin 2012

Pjesa IV Aplikimi tarifor për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes

Pjesa V Aplikimi tarifor për Furnizuesin Publik të Energjisë Elektrike

Pjesa e III-të e aplikimit do të shfrytëzojë informatat e Bilancit të Energjisë për vitin 2012 dhe Tarifave të Gjenerimit për të përcaktuar çmimin e energjisë me shumicë për vitin 2012, së bashku me informacionin që ka të bëjë me koston e vlerësuar të importeve, blerjeve nga gjeneratorët e tjerë të vendit, dhe eksportet.

KEK-u me respekt kërkon që ZRRE-ja të shqyrtojë këtë pjesë të aplikacionit tarifor të KEK-ut sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që procesi tarifor 2012 të mund të ecë me kohë për të zbatuar një rregullim të shitjes me pakicë më 1 prill 2012. Prosesi tashmë është prapa orarit të përshkruar në rregullat e çmimeve. KEK-u gjithashtu paraqet aplikimin e saj tarifor për Gjeneratorin Publik (Pjesa II e aplikacionit tarifor) së bashku me këtë dokument. Miratimi i tarifës së gjenerimit (Pjesa II e aplikacionit tarifor) dhe më pas i çmimit me shumicë të energjisë elektrike në këtë dokument janë më se të domosdoshme. Çmimi i shitjes me shumicë të energjisë elektrike është një kontribut vendimtar për aplikacionet për tarifat e Shfrytëzimit të Sistemit të Shpërndarjes, Operatorit të Sistemit të Transmisionit, dhe për tarifat e Furnizuesit Publik.

II. Supozimet e bëra për të zhvilluar çmimin me shumicë të Energjisë Elektrike

Neni 13 i Rregullës për vendosjen e çmimit për energji elektrike të furnizuesit publik në nenin 13 specifikon se Kostot e energjisë elektrike me shumicë do të përcaktohen si në vijim:

Kostot e lejuara të energjisë me shumicë

1. *Kostot e lejuara të shitjes së energjisë me shumicë duhet të përmbajnë:*
 - 1.1 *Kostot e lejuara me shumicë të kapacitetit;*
 - 1.2 *Kostot e lejuara të energjisë me shumicë; dhe*
 - 1.3 *Marzha me pakicë në kostot e lejuara me shumicë të kapacitetit dhe kostot e energjisë me shumicë.*
2. *Të hyrat e lejuara maksimale duhet të përshtaten për të marrë parasysh ndryshimet në kostot e lejuara me shumicë të energjisë në secilin azhurnim vjetor sipas formulës së dhënë në Shtojcën 1.*
3. *Kostot e lejuara të kapacitetit me shumicë janë ato kosto të ndërlidhura me pagesën e ngarkesave të kapacitetit për kapacitet gjenerues vendor, i cili kontraktohet për qëllime të garantimit të sigurisë së furnizimit dhe ka të bëjë me furnizimin e konsumatorëve të rregulluar.*
4. *Kostot e lejuara të energjisë me shumicë që kanë të bëjnë me shërbimin për konsumatorët e rregulluar përfshijnë:*
 - 4.1 *Kostot e blerjes së energjisë nga gjenerimi vendor;*
 - 4.2 *Kostot e importit të energjisë;*
 - 4.3 *Të hyrat e eksportit të energjisë (si kosto negative), që i nënshtrohen faktorit ndarës të eksportit;*
 - 4.4 *Kostot neto të debalancit, që i nënshtrohen faktorit ndarës të debalancit.*
5. *Të hyrat që kanë të bëjnë me shitjen e energjisë OST-së dhe OSSH-së për të mbuluar humbjet në transmision dhe në shpërndarje do të zbriten nga kostoja e lejuar e energjisë me shumicë, për të shmangur kthimin e koston së humbjeve të energjisë dy herë.*
6. *Kostot e lejuara të blerjeve të energjisë nga gjenerimi vendor përfshijnë koston e realizuar të FPEE-së për blerjen e energjisë nga gjeneratorët në Kosovë (si të rregulluar, ashtu edhe të parregulluar) për të furnizuar konsumatorët e rregulluar, siç përcaktohet në marrëveshjet për blerjen e energjisë apo në formë tjetër, minus kostot e lejuara të kapacitetit me shumicë.*
7. *Kostot e lejuara të blerjeve të energjisë nga gjenerimi vendor i energjisë nuk do të përfshijnë koston shtesë të gjenerimit që mbulohen nga mekanizmat e veçantë, siç është për shembull ndryshimi në mes të nivelit të tarifës Feed-in dhe koston mesatare të energjisë me shumicë, që përdoret për blerje të energjisë nga gjeneratorët e burimeve të ripërtëritshme.*
8. *Kostoja e lejuar e blerjes së energjisë nga importi do të jetë kostoja e realizuar nga FPEE-ja për blerjen e energjisë nga importi, e përcaktuar nga kontratat e importit, minus subvencionet për import të dhëna nga Qeveria e Kosovës.*

Zyra për Çështje Rregullative

9. *Të hyrat e lejuara të eksportit të energjisë do të jenë të hyrat e realizuara që FPEE i fiton me anë të shitjes së energjisë së eksportuar.*
10. *Faktori ndarës i eksportit duhet të jetë një përqindje fikse që aplikohet në të hyrat e eksportit për të përcaktuar ndarjen e këtyre të hyrave në mes të FPEE-së dhe konsumatorëve të rregulluar. Faktori ndarës i eksportit duhet të jetë i mjaftueshëm për të inkurajuar FPEE-në që të maksimizojë të hyrat e eksportit, por të mos rezultojë në përfitime të tepruara për FPEE-në.*
11. *Kostot e lejuara neto të debalancit do të përfshijnë kostot e realizuara minus të hyrat e fituara (siç përcaktohen në pajtueshmëri me rregullat e tregut) që rezultojnë nga debalancet në mes të kërkesës së realizuar nga konsumatorët e rregulluar dhe furnizimi i kontraktuar me energji.*
12. *Faktori ndarës i debalancit duhet të jetë një përqindje fikse që aplikohet në kostot neto të debalancit për të përcaktuar ndarjen e këtyre shpenzimeve në mes të FPEE-së dhe Konsumatorëve të rregulluar, ku vlera prej 0% nënkupton që të gjitha kostot neto të debalancit u alokohen FPEE-së, ndërsa vlera prej 100% nënkupton që të gjitha kostot neto të debalancit u alokohen konsumatorëve. Gjatë përcaktimit të Faktorit ndarës të debalancit, rregullatori duhet të marrë parasysh se deri në ç'masë është në gjendje FPEE-ja që të menaxhojë debalancet dhe, në veçanti, balancin në mes të furnizimeve nga prodhimi vendor dhe importet e qëndrueshme si dhe kërkesës së përmbushur nga FPEE-ja. Rregullatori duhet ta caktojë faktorin ndarës të debalancit në 100% deri në momentin kur konsideron se furnizimi është në përgjithësi adekuat për të plotësuar kërkesat.*
13. *Të hyrat e lejuara që kanë të bëjnë me humbjet e energjisë në transmision apo në shpërndarje përbëhen nga vlera e realizuar e faturës që lëshohet nga FPEE-ja për OSSH-në dhe OST-në (siç përcaktohet në rregullat e tregut) për të kompensuar për ndryshimin në mes të energjisë së matur të dërguar nga gjeneratorët apo të importuar dhe energjisë së shpërndarë deri te konsumatorët e kualifikuar dhe të pakualifikuar.*
14. *Parashikimet e kostove të lejuara me shumicë të energjisë gjatë azhurnimeve vjetore do të marrin parasysh:*
 - 14.1. *Ndryshimet e reja dhe ato historike të çmimit të importit, eksportit, kostos së gjenerimit vendor, si dhe të hyrat që kanë të bëjnë me humbjet në transmision dhe në shpërndarje;*
 - 14.2. *Ndryshimet sezonale në çmimet e eksportit dhe të importit;*
 - 14.3. *Çmimet e kontratave përkatëse për shkëmbim të energjisë; dhe*
 - 14.4. *Faktorët e tjerë që ofrojnë mekanizma të besueshëm për parashikimin e kostos së energjisë me shumicë.*
15. *Rregullatori, bazuar në vlerësimin e tij, mundet të sjellë në përdorim një gjobë eksporti, e cila zbritet nga të hyrat e lejuara maksimale. Kjo gjobë do të aplikohet nëse FPEE-ja eksporton energji dhe nuk mbulon kërkesën e brendshme për energji, për shkak të gjenerimit apo importeve joadekuate, siç është evidentuar në të dhënat e barazimeve të përgatitura nga OST. Gjoha për njësi do të ishte e mjaftueshme për të garantuar që FPEE-ja të ketë nxitje të fuqishme për t'i shërbyer kërkesës së brendshme para eksportimit, por nuk duhet të kërcënojë pozitën financiare të FPEE-së. Çdo gjobë e tillë duhet të sillet në përdorim vetëm nëse dhe në rastet kur rregullatori e konsideron se ka dëshmi se volume të konsiderueshme eksportesh janë duke u ndërmarrë nga FPEE-ja gjatë kohëve të reduktimeve të brendshme.*
16. *Marzha me pakicë do të jetë një përqindje fikse që aplikohet në kostot e lejuara të energjisë me shumicë dhe kostot e lejuara të kapacitetit me shumicë. Ajo duhet të caktohet në atë nivel që:*

Zyra për Çështje Rregullative

- 16.1. *T'i sigurojë FPEE-së përfitim të arsyeshëm që ta kompensojë për rreziqet që ndërmerr gjatë ofrimit të shërbimit standard për konsumatorët e rregulluar. Kjo duhet të llogaritet duke iu referuar marzhave të fituara nga kompanitë e ngjashme në vende të tjera në Evropë, duke marrë parasysh ngjashmëritë në mes të industrisë së energjisë elektrike në ato vende dhe atë të Kosovës; dhe*
- 16.2. *T'i sigurojë FPEE-së kthim të arsyeshëm nga asetet fikse neto të saj të përdorura gjatë ofrimit të shërbimit standard për konsumatorët e rregulluar. Kjo duhet të llogaritet duke iu referuar kostos së kapitalit të të licencuarve të tjerë në Kosovë.*

Për të qenë në përputhje me dispozitat e kostos së shitjes me shumicë të Rregullës për çmimet e FPEE, KEK-u ka shfrytëzuar të dhënat, vlerësimet dhe supozimet si më poshtë:

- a. Bilanci final i Energjisë për 2012 që KEK-u i ka dërguar KOSTT-it më 27 dhjetor 2011 është përdorur për të përcaktuar rrjedhjat e energjisë. Për një përmbledhje, shih tabelën 1 të Bilancit të Energjisë 2012.
- b. Ngarkesat e kapacitetit dhe të energjisë nga Gjeneratori Publik janë përdorur, ashtu siç janë përfshirë edhe në aplikacionin e dorëzuar në ZRRE më 05 janar 2012.
- c. Energjia e blerë nga HC Ujmani është me çmim sipas çmimit aktual të kontratës prej 27,5 € për MWh. Edhe pse Iber Lepenci ka kërkuar një rritje në atë çmim, ata ende nuk e kanë dokumentuar dhe justifikuar një çmim të ri, i cili në fund të fundit duhet të miratohet nga ZRRE-ja. Për këtë arsye, supozohet që çmimi të mbetet në 27,5 € për MWh.
- d. Energjia e blerë nga burime të tjera vendore është me çmim sipas çmimeve aktuale të kontratës.
- e. Energjia e importuar është me çmim prej 70 € për MWh, bazuar në koston aktuale të importit në vitin 2011. Pra, ky çmim është mjaft konservator duke pasur parasysh rritjen në çmimet e energjisë rajonale kohëve të fundit të shkaktuara nga një sërë faktorësh duke përfshirë kushtet e thatësisë në rajon dhe njoftimit për mbylljen e njësisive bërthamore të Gjermanisë për shkak të incidentit në Fukushima të Japonisë.
- f. Subvencionet nga Qeveria e Kosovës NUK janë marrë parasysh në përcaktimin e kostove të energjisë elektrike me shumicë, që i korrespondon trajtimit rregullator në të kaluarën. Përfshirja e subvencionimit nga Qeveria shtrembëron koston aktuale të energjisë dhe meqë subvencionimi aktual ka të ngjarë të ndryshojë nga shuma e buxhetuar, është mirë të mbahet si një linjë e veçantë për Furnizuesin Publik. Në aplikacionin e saj tarifor 2011, KEK-u ka paraqitur tarifat kosto reflektive dhe në këtë kontekst ka rekomanduar që subvencioni të ndahet plotësisht për konsumatorë shtëpiak për të reduktuar për ta sasinë e caktuar të të Hyrave të Lejuara. Këtë vit KEK-u rekomandon një trajtim të ngjashëm.
- g. Eksportet e energjisë janë me çmim prej € 30 për MWH, afërsisht sa kostoja e gjenerimit nga KEK-u.
- h. Ashtu siç KEK-u kishte komunikuar me ZRRE-në dhe këshilltarët e sajë gjatë zhvillimit të Rregullave të çmimeve, eksportet e energjisë në Kosovë nuk bëhen për qëllime të fitimeve. Ato, aktualisht dhe kryesisht bëhen si një mekanizëm balancues

Zyra për Çështje Rregullative

në mënyrë që tepricat e përkohshme të shfrytëzohen efektivisht. Në mjedis të ri, eksportet kryesisht do të bëhen në rast se nominimi për ditën në vijim rezulton të jetë i ekzagjeruar, faktori kryesor i të cilit shpesh është moti. Eksportet nuk bëhen për të përfituar nga eksportimi i energjisë së Kosovës me kosto të ulët në vendet e tjera për të fituar para. KEK-u pret që të ardhurat nga eksporti t'i bartë në mënyrë të plotë tek konsumatorët dhe, prandaj, Faktori Ndarës i Eksportit është zero.

- i.** Po ashtu, dënimi për eksport shpërfill natyrën e vërtetë të balancimit të furnizimit dhe kërkesës. Duke pasur parasysh sasinë e vogël të eksportit që aktualisht po ndodhë dhe parashikohet në Bilancin e Energjisë (më pak se 3% të energjisë në dispozicion), e bën të qartë se furnizuesi nuk është duke u përpjekur që të mbledhë fitime nga eksportet. Çmimet e energjisë janë shumë herë të varura brenda një dite, dhe marrëveshjet për eksport të negociuara me kujdes mund të mos jenë fleksibël nga ora në orë. Në çdo periudhë të dhënë 24 orëshe është e logjikshme për të aplikuar reduktimin në orët e pikut në mënyrë që mos të bëjmë blerje emergjente me kosto të lartë, gjersa të eksportojmë gjatë natës. Madje edhe nëse gjatë ndonjë ore specifike, KEK-u mund të ketë negociuar një marrëveshje eksporti ose shkëmbimi në avans që duhet të respektohet dhe nëse cilado prej furnizimeve është më e ultë (për shkak të rënies së papritur të njësisë gjeneruese) ose kërkesa e konsumatorëve është më e madhe (zakonisht për shkak të motit) reduktimi është i nevojshëm për të mbajtur sistemin në balanc. Një situatë e ngjajshme ndodh edhe në rast të kompenzimit, e cila duhet të shpërndahet ose mirret në orë specifike. Për arsyet e mësipërme, dënimi për eksport është zero.
- j.** Meqë Rregullat e Tregut janë ende në fazën e zhvillimit, shpenzimet e mosbalancimit nuk janë të rëndësishme në këtë kohë dhe nuk janë përfshirë në koston energjisë me shumicë.
- k.** Margjina e shitjes me pakicë ka për qëllim të kompensojë Furnizuesin Publik për rrezikun që merr në ofrimin e shërbimeve standarde për konsumatorët e rregulluar dhe për të siguruar një kthim të investimit për FPEE. Një përmbledhje e të dhënave në dispozicion nga OFGEM tregon një ndryshim të gjerë në kufijtë e shitjes me pakicë aktualisht të fituara nga furnizuesit e gazit dhe energjisë elektrike. Furnizuesi Publik i Kosovës ballafaqohet me rreziqe shumë më të mëdha se sa shërbimet në vendet shumë më të zhvilluara, prandaj, KEK-u propozon që Margjina e shitjes me pakicë të vendoset në 5%.
- l.** Siç kemi rënë dakord me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, deri në kohën kur Distribucioni i KEK-u të ketë qasje të plotë në objektet e shpërndarjes të rrjetit në Veri të Kosovës dhe të funksionimit të furnizimit, kostoja e energjisë së shpërndarë nga KOSTT-i në Veri të Kosovës do të mbulohet si pjesë e koston së shitjes me shumicë të energjisë. Kjo është një mënyrë më transparente dhe logjike për të trajtuar këtë çështje të vështirë politike. Sasia e energjisë është e njehsuar dhe kuantifikohet në raportet e kontabilitetit të energjisë së KEK-ut në baza mujore. Praktika paraprake e të shtuarit të kësaj energjie (e cila është e kalkuluar) në humbjet komerciale të shpërndarjes (e cila sipas definicionit është "e pa kalkulueshme" për energjinë) thjesht nuk është më praktike. Energjia e tillë nuk dërgohet në ndonjë objekt të cilin Distribucioni i KEK-ut e kontrollon, dhe investitorët potencial të KEDS-it nuk duhet të presin që të paguajnë për ndonjë energji të shpërndarë në zonë në të cilën nuk kanë qasje.
- m.** Kosova A dhe Kosova B kërkojnë energji elektrike ndihmëse në mënyrë që të operojnë. Afërsisht 75% e energjisë së tillë sigurohet nga vetë njësitë, ndërsa pjesa

Zyra për Çështje Rregullative

tjetër është e siguruar nga rrjeti i shpërndarjes në 35 KV dhe 10 KV. Duke pasur parasysh ndarjen e Rrjetit dhe Furnizimit nga KEK-u, energjia e tillë duhet paguar prej tarifave me pakicë, e ngjashme me atë energji që përdoret nga minierat. Prodhimi neto i Kosovës A dhe B është rregulluar në përcaktimin e kostove të energjisë me shumicë për të pasqyruar këtë.

Bazuar në vlerësimet dhe supozimet e diskutuara më lart, KEK-u ka zhvilluar koston e rekomanduar të shitjes së energjisë me shumicë për 2012, që tregohet në seksionin III.

Tabela 1 – Balanci i Energjisë për vitin 2012

Linja Nr.	Hyrja/Dalja Përshkrimi	Sasia MWh
1	Kosova A Gjenerimi Neto (Neto me të gjitha shpenzimet vetanake)	1,475.3
2	Kosova B Gjenerimi Neto (Neto me të gjitha shpenzimet vetanake)	3,392.5
3	Gjenerimi nga Ujmani	82.0
4	Importet	820.8
5	Totali në Sistemin e Transmisionit (1 + 2 +3 + a4)	5,770.6
6	Shitjet nga Transmisioni	744.6
7	Shfrytëzimi nga KEK-u	20.4
8	Minierat	111.0
9	Eksportet	169.8
10	Humbjet në Transmision	128.2
11	Teprica	13.3
12	Totali nga Transmisioni (6 + 7 + 8 + 9 + 10 + 11)	1,187.3
13	Neto në Sistemin e Shpërndarjes (5 - 12)	4,583.3
14	Gjeneratorët e kyçur në Sistemin e Shpërndarjes	51.5
15	Energjia e furnizuar nga KOSTT-i në Veri të Kosovës	203.7
16	Humbjet Teknike dhe Komerciale te Shpërndarjes	1,543.3
17	Neto për shitjet në Nivelin e Shpërndarjes (13 + 14 - 15 - 16)	2,887.8
	Shitjet në Nivel të Shpërndarjes	
18	35 kV	40.0
19	10 kV	200.0
20	0.4 kV	2,647.8
21	Totali (18 + 19 + 20)	2,887.8

III. Caktimi i çmimit të shitjes së energjisë me shumicë për vitin 2012

Tabela 2 paraqet rekomandimin e KEK-ut për ZRRE-në për çmimin e energjisë elektrike me shumicë.

Tabela 2 Çmimi i energjisë elektrike me shumicë për vitin 2012**KOSTOJA E ENERGISË ME SHUMICË PËR VITIN 2012**

(Energjia në MWH dhe vlerat monetare në mijëra euro, me përjashtim të vlerave për njësi)

	Energjia MWH	Kostoja (€000)	Kosto për MWH
Kosova A			
Prodhimi neto për Bilancin Ener.	1,475,300		
Energji Ndhmëse Jashtë Vendit	77,000		
Hyrjet në Sistem	1,552,300		
Kosova B			
Prodhimi neto për Bilancin Ener.	3,392,500		
Energji Ndhmëse Jashtë Vendit	77,700		
Hyrjet në Sistem	3,470,200		
Hyrjet e Gjenerimit të KEK-ut në Sistem	5,022,500	149,407	29.75
Ujmani	82,000	2,255	27.50
Importi	820,800	57,456	70.00
Eksporti	(169,800)	(5,094)	30.00
Energjia në Veri	(203,700)		
Kostoja e Energjisë me Shumicë (Transmisioni)	5,551,800	204,024	36.75
Gjenerimi i Lidhur i Distribucionit	51,522	2,246	43.60
Kostoja e Energjisë me Shumicë (Distribucioni)	5,603,322	206,270	36.81

Çmimet e mësipërme nuk e përfshijnë Marzhën e Shitjes me Pakicë prej 5%

Kostot Finale të Energjisë me Shumicë, përfshirë edhe Marzhën e Shitjes me Pakicë prej 5%:	
Kostoja e Energjisë me Shumicë (Transmisioni)	38.59
Kostoja e Energjisë me Shumicë (Distribucioni)	38.65